


REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

RREGULLORE PËR TATIMIN MBI PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2020

Tetor 2019

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 9 të Ligjit Nr.06/ L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 2 e datës 15 shkurt 2018 si dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008 , Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 26. 11. 2019, pas shqyrtimit të propozim Rregullores të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

RREGULLORE
PËR TATIMIN NË PRONËN E PALUAJTSHME PËR VITIN 2020

I.DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Objekti i rregullimit

Me këtë Rregullore, përcaktohen normat tatimore për vitin 2020, për të gjitha kategoritë e pronave të paluajtshme me përjashtim të kategorisë pronë publike, brenda kufijve të përcaktuar me dispozitat e nenit 9 të Ligjit për Tatimin në Pronën e paluajtshme.

Neni 2

Baza Tatimore

1.Për vitin 2020 zonat tatimore dhe nivelet e vlerave për M² në Komunën e Lipjanit, caktohen si vijon:

Kategoria e Vlerës	Nivelet e vlerave për M ²			
	Zona I	Zona II	Zona III	Zona IV
1. Pronë komerciale				
1.1. Shitore	600.00 €	400.00 €	300.00€	200.00€
1.2. Zyrë	600.00 €	400.00 €	300.00€	200.00€
1.3. Restorant	600.00 €	400.00 €	300.00€	200.00€
1.4. Hotel	600.00 €	400.00 €	300.00€	200.00€
1.5. Objekt për magazinim komercial	300.00 €	250.00 €	200.00€	150.00€
1.6. Garazh komercial	250.00€	200.00 €	150.00€	100.00€
1.7. Pishinë për shfrytëzim komercial	80.00 €	80.00 €	80.00€	80.00€
1.8. Fushë e hapur sportive	80.00 €	80.00 €	80.00€	80.00€
1.9. Fushë e mbyllur sportive	80.00 €	80.00 €	80.00€	80.00€

1.10. Pompë benzine	600.00 €	400.00 €	300.00€	200.00€
1.11. Objekt tjetër komercial	600.00 €	400.00 €	300.00€	200 00€
2. Pronë industriale				
2.1. Fabrikë	350.00 €	300.00 €	250.00€	200.00€
2.2. Punishte	350.00 €	300.00 €	250.00€	200.00€
2.3. Objekt për magazinim industrial	350.00 €	300.00 €	250.00€	200.00€
2.4. Objekt tjetër industrial	350.00 €	300.00 €	250.00€	200.00€

2. Duke u bazuar në dispozitat e Ligjit nr. 06/l-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, kompetent për zbatimin e procedurës së vlerësimit është Ministria e Financave konform:

Nenit 17 pika 1, në të cilin theksohet si vijon:

“Ministria e Financave përcakton zonat e vlerave, nivelet e vlerave dhe vlerën e vlerësuar të pronave të paluajtshme që janë brenda territorit të komunave. Vlerësimi i pronave të paluajtshme kryhet në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara në këtë Ligj dhe në aktin nënligjor që nxjerr Ministria e Financave për kategoritë e vlerave, metodat dhe modelet e vlerësimit”. Dhe

Neni 18 pika 4, në të cilin theksohet si vijon:

“Vlera e vlerësuar e njësive të parcelave e përcaktuar në përputhje me paragrafin 2. Të këtij neni dhe vlera e njësive të objekteve e përcaktuar në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, janë të vlefshme deri në procesin e ardhshëm të vlerësimit që kryhet në përputhje me paragrafët 1. Dhe 7. Të këtij neni.

II. ZONAT TATIMORE

Neni 3

Përcaktimi i zonave tatimore

Duke u bazuar ne vendndodhjen e pronës e cila ndikon dukshëm ne vlerën e saj në Komunën e Lipjanit janë përcaktuar katër zona dhe disa nën zona të cilat paraqesin ndryshime të theksuara ne vlerën e njësive të objekteve.

Neni 4

Zona e I-rë tatimore

Zona e –I- tatimore përfshin objektet të cilat sipas sistemit të adresave gjinden në sheshet dhe rrugët e qytetit të Lipjanit , si vijon: Sheshi “Adem Jashari”, Rruga “Hamzë Jashari”, Rruga “Lidhja e Prizrenit”, Rruga “Skenderbeu”, Rruga “Shqipëria”, Rruga “Haradin Bajrami”, Rruga “Shën Flori”, Rruga “Gjergj Fishta”, Rruga “Komandant Kumanova”.

Neni 5

Zona II-të tatimore

1.Zona e II tatimore përfshin objektet të cilat gjinden në rrugët e qytetit të Lipjanit si vijon: "1 Qershori", "24 Marsi", "26 Marsi", "28 Nëntori", "Afrim Zhitia", "Ahmet Krasniqi", "Ali Hadri", "Ali Podrimja", "Anton Çeta", "Armend Ahmeti", "Arsim Zeqiri", "Avni Rrustemi", "Bahri Fazliu", "Bajrush Shala", "Besëlidhja", "Burimi", "Butrinti", "Epopeja e UÇK-së", "Fehmi Jupa", "Fehmi Lladrovci", "Flaka e Janarit", "Habibe Shehu", "Halit Akllapi", "Hamit Bytyqi", "Hysni Xhemajli", "Idriz Seferi", "Idriz Zejnullahu", "Jeton Fazliu", "Justinjani", "Lekë Dukagjini", "Liburna", "Luigj Gurakuqi", "Maliq Hoti", "Martirët e Akllapit", "Martirët e Lipjanit", "Mic Sokoli", "Miftar Sopi", "Mihailo Pupin", "Milazim Petrova", "Mbreti Agron", "Nezë Buja", "Nuhi Berisha", "Pranvera 81", "Ramiz Shala", "Rashit Mehmeti", "Sadri Duhla", "Sali Rexha", "Sami Frashëri", "Shefki Salihu", "Shën Lauri", "Shkolla e Mesme", "Shyqeri Haziri", "Zekë Luma", "Ibrahim Rugova", "Zenel Emërllahu", "Aleksander Stipqeviq", "Avdi Kelmendi", "Avdi Avdiu", "12 Qershori", "2 Korriku", "7 Shtatori", "Arsim Zeqiri", "Aziz Kelmendi", "Hamdi Bislimi", "Hasan Prishtina", "Xhevdet Breznica", "Zylfie Gashi", "Ismail Luma", "Bajram Curri", "Nënë Tereza", "Kongresi i Blinajës", "Sadik Shala", "Pjetër Bogdani", "Ganimete Tërbeshi", "Haxhi Kleqka", "Ibrahim Krasniqi", "Idriz Ajeti", "Iliria", "Isa Dema", "Isa Olluri", "Ismail Dragusha", "Jetish Akllapi", "Millosh Kopiliqi", "Shaqir Hoxha", "Mbreti Zog", "Fatmir Reçica", "Vezir Kolshi", "Ulpiana", "Bajram Gashi", "Qerim Banulla", "Qamil Olluri", "Mbretreshë Teutë", "Rexhep Akllapi", "Një Maji", "Fehmi Agani", "Bashkim Krasniqi", "Bejtush Gërbeshi", "Myzaqete Begolli", "Selim Vishesella", "Enver Olluri", "Gafurr Hyseni", "Halil Metaj", "Agim Ademi", "Lulzim Llugiqi", "Xhavit Kozhani", "Tahir Sinani", "Malet e Sharrit", "9 Maji", "Revulicioni i Qershorit", "Rexhep Mala", "Haxhi Zeka", "Zahide Jashari", "Ismet Asllani".

2.Në zonën e dytë llogariten edhe të gjitha objektet e banimit dhe të biznesit që gjenden pranë rrugëve magjistrale Prishtinë-Ferizaj, Prishtinë-Prizren, Lipjan-udhëkryqi i Banullës, si dhe Aeroporti i Prishtinës

Neni 6

Zona III-të tatimore

Zona III tatimore përfshin objektet të cilat gjenden në fshatrat e Komunës së Lipjanit si vijon:

Banulla, Bujani, Qellopek, Bregu i Zi, Qylagë, Gadimja e Ulët, Gllanica, Gllavica, Glllogoc, Vrellë e Goleshit, Gadimja e Epërme, Gumnasella, Janjevë, Kojškë, Konjuh, Kraishta, Llugagjia, Magura, Dobraja e Madhe, Dobraja e Vogël, Llugë, Hallaqi i Vogël, Grackë e Vogël, Ribari i Vogël, Marec, Medveci, Babushi i Muhaxherve, Rufc i Ri, Poturofci, Rubofc, Sillovi, Smallushë, Grackë e Vjetër, Rufc i

Vjetër, Topliqan, Torinë, Hallaqi i Madhë, Ribari i Madh, Krojmiri, Shalë, Baicë, Leletiqi, Resinoc, dhe Vërshec.

Neni 7

Zona e IV-të tatimore

1. Zona IV tatimore përfshin objektet të cilat gjenden në fshatrat e Komunës së Lipjanit si vijon:

Hanrofici, Brusi, Bukovica, Divjaka, Kleqkë, Mirenë, Akllapi, Okosnicë, Plitkoviqi, Shisharkë, Teqe, Tërbufci, Varigoc, Vogoqincë, Vrella e Gadimes, Lipovicë dhe Zllakuqan

2. Te objektet komerciale, për bodrumet do të llogaritet $\frac{1}{2}$ e sipërfaqes së objektit.

Neni 8

Normat Tatimore

1. Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, Kuvendi Komunal i Komunës së Lipjanit cakton normat tatimore për vitin 2020 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

Kategoria e Pronës	Norma tatimore
Për njësitë bujqësore të parcelave	0.15 %
Për njësitë bujqësore të objekteve	0.15%
Për njësitë pyjore të parcelave	0.15 %
Për njësitë rezidenciale të parcelave	0.15 %
Për njësitë rezidenciale të objekteve	0.15%
Për njësitë komerciale të parcelave	0.30 %
Për njësitë komerciale të objekteve	0.30 %
Për njësitë industriale të parcelave	0.20 %
Për njësitë industriale të objekteve	0.20 %

2. Në bazën tatimore do të llogaritet koeficienti mbi gjendjen e ndërtesës. Gjendja e ndërtesës është pamja e jashtme e pronës ku vlerësohet gjendja fizike sipas: vjetërsisë, materialit të ndërtimit, mirëmbajtjes, renovimit, gjendja e fasadës, e ullukëve, e dritareve dhe e kulmit si dhe përshtatshmëria e destinimit apo shfrytëzimit.

3. Gjendja e pronës ndahet në 5 Kategori dhe Koeficientet e gjendjes së ndërtesës janë me sa vijon:

Nr.	Cilësia e pronës – Kategoritë	Koeficienti
1.	E shkëlqyeshme/shumë e mirë	1.1
2.	E Mirë	1.0
3.	Mesatare	0.8
4.	E dobët	0.6
5.	Shumë e dobët (e papërdorshme)	0.5

4. Në raste të veçanta mund të llogariten edhe amortizime të tjera të parapara me Ligjin Nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme.

Neni 9

Pronat e Liruar nga Tatimi në Pronën e Paluajtshme

Pronat të cilat lirohen nga tatimi në pronë e të cilat janë të cekura në nenin 10. të Ligjit nr.06/l-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, lirohen nga tatimi edhe në Komunën e Lipjanit.

Neni 10

Shtyrja e pagimit të tatimit

Shtyrja e pagimit të tatimit në kushte të veçanta mund të bëhet konform nenit 24 të Ligjit nr. 06/l-005 për tatimin në pronën e paluajtshme.

Neni 11

Ankesat ndaj faturës të tatimit në pronë

1.Në pajtim me nenin 12 mbi përgjegjësitë komunale, dhe nenit 31 mbi ankesat ndaj faturës të tatimit në pronë, të Ligjit Nr. 06/l-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, Komuna merr vendim në lidhje me ankesën e dorëzuar brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga pranimi i ankesës. Komuna mund të zgjasë, deri në tridhjetë (30) ditë kalendarike, afatin për shqyrtimin e ankesës së dorëzuar, me një vendim të arsyetuar.

2.Ligji mbi Tatimin në Pronën e Paluajtshme dhe Udhëzimet Administrative të lëshuara nga Ministria e Financave janë bazike dhe rregullojnë të gjitha çështjet tjera të cilat kanë të bëjnë me tatimin në pronë e të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore Komunale.

III.DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 12
Hyria në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës dhe filloj së zbatuari nga 1 janari 2020.

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja mbi tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2019, 15 Nr. 011-71870, datë 27.11.2018 .

Nr.15- 020-75626

Lipjan, më 27. 11. 2019

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo	
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije	
Ministry of Finance	
Arkiva - Arhiva - Archive	
Nr. i Org. Org. Jedin. Org. Unit	09
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	378
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages	31, 10, 2019
Dalëse	PRISHTINË/A

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Financave
Ministarstvo Finansija - Ministry of Finance

Departamenti i Tatimit në Pronë - Odeljenje za porez na imovinu - Department of Property Tax

REFERENCE:					
PËR/ZA/TO:		z. Imri AHMETI, Kryetar i Komunës, Lipjan			
CC:		z. Latif RAMADANI, Drejtor për Buxhet dhe Financa z. Shemsi AZEMI, Menaxher i Tatimit në Pronë			
PËRMES/PREKO/THROUGH:		z. Naim BAFTIU, Sekretar i Përgjithshëm, MF			
NGA/OD/FROM:		Shkelzen MORINA, Drejtor i Departamentit të Tatimit në Pronë, MF			
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:		Raport mbi vlerësimin e përgjithshëm për Objekte Rezidenciale për Komunën Lipjan			
Nr. i zyrës:	DTP	Lokacioni:	MF	Data:	30 Tetor, 2019
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	
Room No:		Extension:		Date:	

I nderuar Kryetar,

Departamenti i Tatimit në Pronë në Ministrinë e Financave në përputhje me nenin 18, paragrafi 5 dhe 6 i Ligjit Nr.06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, ka nxjerrë raportin për Komunën e Lipjanit mbi vlerësimin e përgjithshëm të pronave të paluajtshme, Kategoria e pronës Objekte Rezidenciale (bashkëngjitur kësaj shkrese), në kuadër të të cilit janë përcaktuar zonat e vlerave dhe nivelet e vlerave të pronave të paluajtshme që janë brenda territorit të komunës, në përputhje me nenin 17, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

Raporti i vlerësimit të përgjithshëm është nxjerr pas kryerjes së vlerësimit për të përcaktuar nivelet e vlerave për Shtëpi Familjare, Apartament, Garazhë për Shfrytëzim Privat dhe Objekt tjetër Rezidencial, kategori këto të përcaktuara në përputhje me nenin 4 të UA MF-Nr. 03/2018 për Metodologjinë e Vlerësimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të pronave të paluajtshme Objekteve Rezidenciale, janë analizuar vlerësimet nga komuna përgjatë viteve të mëparshme deri në vitin 2019. Fillimisht është bërë identifikimi i zonës qendër (zona kryesore me çmimin më të lartë për M²) dhe përveç kësaj janë aplikuar koeficientet për derivimin e vlerave nga zona kryesore (zona qendër) në zonat tjera jashtë saj dhe zonat më të largëta.

Aktualisht tregu i pronave rezidenciale në Republikën e Kosovës është i mangët sa i përket kontratave të shitblerjeve gjë që e bën procesin e vlerësimit mjaft kompleks për të përcaktuar nivelin e përafërt të vlerës duke u bazuar në metodën e krahasimit të shitblerjeve. Gjithashtu përgjatë vitit 2019 ka qenë e pamundur krijimi i shtresës së hartës zonale veçmas për Objektet për

Shtëpi Familjare dhe gjithashtu për Apartament. Krijimi këtyre shtresave të hartave për vlerësim do të jetë i mundur gjatë viteve në vijim për të gjitha kategoritë e pronave.

Si rrjedhojë, në mungesë të shitjeve, përveç derivimit të vlerave kemi aplikuar edhe qasjen e simulimit të vlerave të tregut duke aplikuar koeficient për zona dhe nivele të vlerave për ta derivuar nivelin e vlerës nga zona kryesore e komunës (zona qendër) dhe zonat tjera brenda juridiksionit të komunës.

Gjatë procesit të vlerësimit, në mungesë të veglave për ti ndryshuar kufijtë e zonave të vlerave apo edhe krijimit të zonave të reja në mënyrë që të krijohet shtresë e veçantë e hartës zonale për kategoritë e pronave rezidenciale janë përdorur si zgjidhje zonat e njëjta me ato të krijuara për tokat rezidenciale, zonim dhe vlerësim ky i kryer gjatë vitit 2018 dhe i aplikuar për vitin 2019. Kjo, edhe për arsyen se vlera e tokës ndikon edhe në vlerën e objektit, në zonat ku vlera e parcelës rezidenciale është më e lartë, konsiderohet si faktor që ndikon gjithashtu në vlerën e objektit.

Gjatë viteve në vijim do të rishikohen zonat dhe nivelet e vlerave për pronat e paluajtshme të përcaktuara deri më tani, dhe atë, aty ku është e nevojshme ndryshimi i kufijve të zonave ekzistuese apo edhe krijimi i zonave të reja nëse një gjë të këtillë e kërkon tregu i lirë i shitjeve dhe ka informacion të bollshëm.

Për qëllime të tatimit në pronë aplikohet vlerësimi në masë i pronave të paluajtshme, ku pronat brenda një zone të caktuar gjeografike, të së njëjtës kategori vlere, kanë vlera tregu të përafërta e cila nënkupton se niveli i vlerës (çmimi për M²) është i njëjtë në atë zonë vlere të caktuar.

Tatimi në pronë në Republikën e Kosovës është i bazuar në vlerën e tregut, prandaj në të ardhmen për ne dhe Komunën mbetet synim përmirësimi dhe pasqyrimi i përafërt i shitjeve të ndodhura ku një pronë do të shkëmbehej në datën e vlerësimit, mes një shitësi dhe një blerësi të vullnetshëm, përmes një transaksioni ku ata nuk kanë lidhje me njëri tjetrin dhe pasi të jetë bërë marketingu i duhur ku secila nga të dyja palët ka vepruar në mënyrë të vetëdijshme, me maturi dhe pa ndonjë detyrim.

Gjatë periudhës sa është punuar në vlerësimin e pronave rezidenciale janë zhvilluar takime me zyrtarët e Zyrave për Tatimin në Pronë të komunës për të koordinuar dhe harmonizuar idetë, propozimet dhe sugjerimet në lidhje me vlerësimin e kësaj kategorie të pronave për vitin e parë të vlerësimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Raporti mbi vlerësimin e përgjithshëm për Komunën Lipjan (bashkëngjitur kësaj shkrese) përmban informacionin si vijon:

- emrin e Komunës;
- datën e nxjerrjes;
- nivelin/nivelet e vlerës/vlerave për çdo zonë vlere;
- hartat e zonave të vlerave; dhe
- një përshkrim të çdo zone vlere;

Me respekt!



RAPORT MBI VLERËSIMIN E PËRGJITHSHËM

Komuna: LIPJAN

Data e nxjerrjes: 30.10.2019

NJËSITË REZIDENCIALE TË OBJEKTEVE

- Niveli/Nivelet e vlerës/vlerave në çdo zonë vlere.

Nivelet e Vlerave (€/m ²)					
LIPJAN					
OBJEKTE REZIDENCIALE					
Numri i Zonës së Vlerës	Kategoria e Vlerës				
	Shtëpi familjare	Apartament	Garazh për shfrytëzim privat	Objekt tjetër rezidencial	
1301	€ 180.00	€ 220.00	€ 70.00	€ 70.00	
1302	€ 160.00	€ 160.00	€ 60.00	€ 60.00	
1303	€ 200.00	€ 220.00	€ 80.00	€ 80.00	
1304	€ 200.00	€ 220.00	€ 80.00	€ 80.00	
1305	€ 200.00	€ 220.00	€ 80.00	€ 80.00	
1306	€ 300.00	€ 300.00	€ 120.00	€ 120.00	
1307	€ 300.00	€ 300.00	€ 120.00	€ 120.00	
1308	€ 375.00	€ 400.00	€ 150.00	€ 150.00	

Harta e zonave të vlerave



PËRSHKRIMI I ZONAVE TË VLERAVE.

Numri i zonës së vlerës: 1301

1. **Emri i zonës së vlerës:** Lipjan Perëndim.
2. **Përshkrim i zonës së vlerës:** Zona perëndimore e komunës së Lipjanit e cila kufizohet me Komunën e Shtimes, Suharekës, Malishevës, Gllogocit, Fushë Kosovës dhe Graçanicës. Kryesisht zone rurale dhe malore.
3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.
4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.

Numri i zonës së vlerës: 1302

1. **Emri i zonës së vlerës:** Lipjan Lindje.
2. **Përshkrim i zonës së vlerës:** Pjesa më e madhe e zonës së vlerës është rurale dhe malore. Është periferia e Komunës së Lipjanit e cila kufizohet me Komunën e Graçanicës, Prishtinës, Novobërdës, Gjilanit dhe Ferizajt.
3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.
4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.

Numri i zonës së vlerës: 1303

1. **Emri i zonës së vlerës:** Janjeva Qendër.
2. **Përshkrim i zonës së vlerës:** Kjo pjesë e përfshinë qendrën e Janjevës, karakterizohet me dendësi sa i përket vendbanimit.
3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.
4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.

Numri i zonës së vlerësimit: 1304

1. **Emri i zonës së vlerës:** Gracke, Konjuh, Babush i Muhaxherve, Sllavi.
2. **Përshkrim i zonës së vlerës:** Zona periferike e qytetit e cila kufizohet me Komunën e Graçanicës, Ferizajt dhe Shtimes, brenda së cilës janë disa fshatra kryesisht karakterizohet me pozite të rrafshët.
3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.
4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.

Numri i zonës së vlerës: 1305

1. **Emri i zonës së vlerës:** Lipjan Urbane Perëndim.
2. **Përshkrim i zonës së vlerës:** Pjesa më e madhe e zonës së vlerës kufizohet me qendrën e qytetit rreth arterieve kryesore dhe rrugëve magjistrale.
3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.
4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.

Numri i zonës së vlerësimit: 1306

1. **Emri i zonës së vlerës:** Lipjan Urbane Lindje.
2. **Përshkrim i zonës së vlerës:** Pjesa më e madhe e zonës së vlerës është në Lindje të zonës qendër (zonës kryesore) e cila karakterizohet me ndërtime të ulëta, kryesisht shtëpi familjare e cila ka infrastrukturë dhe ofrohen shërbime publike që mirëmbahen në mënyrë të rregullt.

3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.
4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.

Numri i zonës së vlerësimit: 1307

1. **Emri i zonës së vlerës:** Lipjan Urbane Veri
2. **Përshkrim i zonës së vlerës:** Pjesa më e madhe e zonës së vlerës është në veri të zonës qendër (zonës kryesore) e cila karakterizohet me ndërtime të ulëta, kryesisht shtëpi familjare e cila ka infrastrukturë dhe ofrohen shërbime publike që mirëmbahen në mënyrë të rregullt.
3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.
4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.

Numri i zonës së vlerësimit: 1308

1. **Emri i zonës së vlerës:** Lipjan Urbane Qendër.
2. **Përshkrim i zonës së vlerës:** Kjo zonë e vlerës përfshinë qendrën e qytetit dhe karakterizohet si zona më kryesore e komunës, e zhvilluar për nga infrastruktura, shërbimet publike e cila mirëmbahet në mënyrë të veçantë për dallim nga zonat tjera. Popullimi dhe frekuentimi i qytetarëve në këtë zonë është më i theksuar.
3. **Të dhënat e shitblerjeve:** Nuk ka të dhëna.
4. **Vlerësimi:** Niveli i derivuar i vlerës përmes koeficienteve dhe simulimi i tregut.
5. **Burimi i informatave:** Baza tatimore e aplikuar nga Zyra e Tatimit në Pronë dhe intervistat.

Shkelzen MORINA





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije – Ministry of Finance

Zyra e Ministrit/ Kancelarija Ministra/ Cabinet of the Minister

Prishtinë 24 Tetor 2019

Në mbështetje të nenit 8 nën paragrafi 1.4 të Rregullores Nr.02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (*Gazeta Zyrtare Nr.1, Datë 18.04.2011*):

Nr. 32/2019

Nxjerr:

VENDIM

1. Lirohen nga tatimi në pronë të gjithë parcelat bujqësore, për vitin tatimor 2020.
2. Ngarkohen Departamenti i Tatimit në Pronë në Ministrinë e Financave dhe Zyrat e Tatimit në Pronë në Komuna për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Me respekt,

Bedri Hamza
Ministër i Financave

